



VENDIM MBI PAPRANUESHMËRI

Data e miratimit: 15 qershor 2015

Numri i lëndës: 2014-42

Bujar Zherka

kundër

EULEX-it

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut i mbledhur me 15 qershor 2015, ku të pranishëm ishin anëtarët e paraqitur në vijim:

Znj. Magda MIERZEWSKA, kryesuese
Z. Guénaël METTRAUX, anëtar
Znj. Katja DOMINIK, anëtare

Ndihmuar nga
Z. John J. Ryan, zyrtar i lartë ligjor
Znj. Joanna MARSZALIK, zyrtare ligjore

Pas shqyrtimit të ankesës së lartpërmendur, e cila është dorëzuar në përputhje me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut dhe rregullores së punës së Panelit siç është ndryshuar së fundi më 15 janar 2013,

Pas shqyrtimit, u vendos si në vijim:

I. PROCEDURAT PRANË PANELIT

1. Ankesa është regjistruar më 9 dhjetor 2014.

II. FAKTET

2. Faktet e mëposhtme janë të vërtetuara nga materiali që është në posedim të Panelit.
3. Më 10 shkurt 2012, prokurori i EULEX-it ka nisur një hetim ndaj R.Z. dhe X.Z. për shkak të dyshimit për dhënie të ryshfetit. Në të njëjtën ditë, prokurori ka paraqitur kërkesë në gjykatën komunale të Pejës për urdhër për bastisjen e pronës së shfrytëzuara dhe në pronësi të të dyshuarit.
4. Më 14 shkurt 2012, gjyqtari i procedurës paraprake i EULEX-it në gjykatën komunale ka lëshuar një urdhër për bastisje, që duhej të ekzekutohej brenda 48 orëve nga lëshimi i tij.
5. Nuk është e qartë nga ankesa se kur ishte zbatuar urdhri për bastisje dhe nëse ka pasur ndonjë çfarë gjëra janë konfiskuar. Një dëftesë e konfiskimit të një numri të gjërave që i përkasin personit I.Z. dhe që ishin konfiskuar në pronën e të dyshuarve është lëshuar nga policia e Kosovës më 2 mars 2012. Megjithatë nuk është e qartë se kur ishin konfiskuar ato dhe me çfarë urdhri të gjykatës ishte zbatuar.
6. Më 2 prill 2012, gjyqtari i procedurës paraprake i EULEX-it në gjykatën komunale, me kërkesë të Prokurorisë së EULEX-it, ka lëshuar një tjetër urdhër për bastisje në pronën që i takonte R.Z. dhe X.Z.
7. Në të njëjtën ditë, një numër i gjërave ishin konfiskuar nga R.Z. dhe X.Z. Një dëftesë e gjërave të konfiskuara ishte lëshuar më 2 prill 2012, ku tregon se ato ishin pronësi e I.Z.
8. Më 23 maj 2013, gjykata themelore e Pejës ka dënuar R.Z. dhe X.Z. së bashku me dy të pandehur të tjerë për ushtrim të ndikimit dhe nxitje për keqpërdorim të pozitës zyrtare ose autoritetit.
9. Më 6 qershor 2014, gjykata e apelit në përbërje të një trupi gjykues të përzier të gjykatësve të Kosovës dhe EULEX-it, ka ndryshuar pjesërisht aktgjykimin e shkallës së parë. Ajo gjithashtu ka urdhëruar që një numër i gjërave të konfiskuara gjatë bastisjes së shtëpisë në pronën e të pandehurve të kthehen.

III. ANKESAT

10. Ankuesi kërkon që gjërat e konfiskuara gjatë kontrollit në pronën e R.Z.-së dhe X.Z.-së t'i kthehen atij.

IV. LIGJI

11. Si çështje e së drejtës materiale, Paneli është i autorizuar për të përdorur instrumentet e të drejtave të njeriut siç pasqyrohen në konceptin llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 mbi themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut. Me rëndësi të veçantë për punën e Panelit janë Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (Konventa) dhe Konventa Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike, të cilat përcaktojnë standardet minimale për mbrojtjen e të drejtave të njeriut që duhet të garantohen nga autoritetet publike në të gjitha sistemet ligjore demokratike.
12. Para shqyrtimit të bazueshmërisë së ankesës, Paneli duhet të vendos nëse do ta pranoj ankesën, duke marrë parasysh kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me rregullën 29 të rregullores së vet të punës.
13. Sipas rregullës 25, paragrafit 1 të rregullores së vet të punës, Paneli mund të shqyrtojë ankesat që kanë të bëjnë me shkeljet e të drejtave të njeriut nga ana e EULEX-i në Kosovë gjatë ushtrimit të mandatit të tij ekzekutiv në fushën e drejtësisë, policisë dhe doganave.
14. Ankuesi pohon se i ishin konfiskuar gjëra të caktuara që i përkasin atij, me sa duket gjatë bastisjes së shtëpisë së R.Z.-së dhe X.Z.-së dhe se ato nuk i janë kthyer atij. Së pari Paneli vëren se nuk është ofruar asnjë përshkrim i këtyre gjërave. Më tej, Panelit nuk i janë ofruar dokumente për të dëshmuar pronësinë e ankuesit ndaj këtyre gjërave. Bastisja është kryer në lokalet, të cilat siç duket nuk kanë qenë pronë e ankuesit. Në dy dëshmitë e konfiskimit, gjërat janë shënuar se i takojnë personit I.Z., e jo ankuesit. Për më tepër, nuk duket se ankuesi ka ndërmarrë ndonjë hap, përveç parashtrimit të ankesës në Panel, për t'i rimarrë ato gjëra. Nuk është argumentuar, e lëre më treguar, se do të kishte qenë e pamundur për atë apo qartas do të kishte qenë e kotë që të parashtronte këtë çështje në gjykatë. Prandaj, Paneli konsideron se ankesa është e pabazuar.

PËR KËTO ARSYE,

Paneli njëzëri konstaton se ankesa është qartas e pabazuar sipas nenit 29 (e) të rregullores së vet të punës, dhe

SHPLL ANKESËN TË PAPANUESHME.

Për Panelin,

John J. RYAN
Zyrtar i lartë ligjor



Magda MIERZEWSKA
Kryesuese